

20040400646

L I G J I
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
OBLIGUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të obligueshëm pensional me financim kapital (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002 dhe 85/2003), në nenin 17 paragrafi (1) fjala “pesë” zëvendësohet me fjalën “tre”.

Neni 2

Në nenin 47 paragrafi (1) pika j), pikëpresja zëvendësohet me lidhëzën “dhe” dhe shtohen fjalët: “përgatit udhëzime profesionale, doracakë dhe ngjashëm, lidhur me sigurimin pensional me financim kapital;”.

Neni 3

Në nenin 58 paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“(3) Të siguruarit, të cilët kanë qenë të inkuadruar në sigurimin e obligueshëm pensional dhe invalidor para 1 janarit 2003 mund të anëtarësohen dhe të paguajnë kontribute në fondin pensional sipas zgjedhjes personale dhe zgjedhjen duhet ta bëjnë më së voni deri më datën e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni”.

Paragrafët (7), (8), (9) dhe (10) ndryshohen si vijojnë:

“(7) Kontributet e të siguruarve të cilët nuk janë anëtarësuar në fondin pensional, ndërsa kanë qenë të obliguar në të, ruhen në llogaritë e veçanta në fondet pensionale, deri në momentin kur i siguruari do të anëtarësohet vullnetarisht në fondin pensional. Agjencia përkohësisht i sistemon këta të siguruar në fondin pensional nga momenti i anëtarësimit të tyre në sigurimin e obligueshëm pensional dhe invalidor.

(8) Gjatë sistemimit të të siguruarve në fondet pensionale, në pajtim me paragrafin (7) të këtij neni, Agjencia siguron që numri i të siguruarve të jetë proporcional me vlerën e përgjithshme të mjeteve të secilit fond të veçantë pensional, në datën të cilën e përcakton Agjencia.

(9) Të siguruarit nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilët nuk do të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim në afat prej tre muajsh nga dita e inkuadrimin në sigurimin e obligueshëm pensional dhe invalidor, pas skadimit të këtij afati janë të obliguar të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim me shoqërinë e cila udhëheq me fondin pensional në të cilën kanë qenë të sistemuar në pajtim me paragrafin (7) dhe (8) të këtij neni. Nëse i siguruari nuk e nënshkruan marrëveshjen për anëtarësim, mjetet e tij ngelin në llogarinë e veçantë në fondin pensional.

(10) Agjencia e rregullon procedurën e sistemimit të të siguruarve në fondet pensionale”.

Neni 4

Në nenin 59 paragrafi (5) ndryshon si vijon:

“(5) Shoqëria e cila udhëheq me fondin pensional, menjëherë pas skadimit të afatit prej tetë ditësh pune pas nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim nga paragrafi (4) i këtij neni, vendos llogari individuale të anëtarit i cili e ka nënshkruar marrëveshjen”.

Neni 5

Në nenin 68 paragrafët (1) dhe (2) ndryshojnë si vijon:

“(1) Mjetet nga kontributet e paguara në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë për të cilat Fondi nuk mund të konstatojë se kujt i takojnë, ruhen në llogari të pidentifikuar në Fond deri sa nuk konstatohet pronësia e atyre mjeteve. Mjetet e kontributeve të

paguara në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë për të cilat ka parregullsi në të dhënat shoqëruese, ruhen në llogarinë e pasistemuar me nënllogari individuale në Fond, deri sa ato parregullsi nuk zgjidhen.

(2) Llogaria e veçantë në Fondin pensional përbëhet prej nënllogarive individuale për secilin të siguruar dhe mjetet në këtë llogari janë të grumbulluara nga kontributet në pajtim me paragrafët (7) dhe (9) nga neni 58 i këtij ligji. Këto mjete, shndërrohen në njësi kontabiliteti dhe investohen në të njëjtën mënyrë si edhe mjetet tjera të fondit pensional, nga ana e shoqërisë.”

Neni 6

Në nenin 69 paragrafi (1) pika gj) ndryshon si vijon:

“pranon të dhëna nga Agjencia për anëtarët e fondeve pensionale dhe për fondet pensionale të cilat ata i kanë zgjedhur, në pajtim me këtë ligj”.

Neni 7

Në nenin 82 në paragrafin (2) fjalët: “secili mjet” zëvendësohen me fjalët: “ mjetet e përgjithshme neto”.

Neni 8

Në nenin 88 paragrafi (1) fjalët: “Kontabilitet i brendshëm” zëvendësohen me fjalën “Kontabilitet”.

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

“(2) Agjencia për së afërmi e rregullon planin llogaritës, formën dhe përmbajtjen e raporteve themelore financiare, raportet plotësuese për fondet pensionale, si dhe përmbajtjen e llogarive të caktuara në planin llogaritës për fondet pensionale.”

Neni 9

Në nenin 98 paragrafi (1) pika b) fjala: “i fundit” zëvendësohet me fjalën: “i pesti”.

Neni 10

Në nenin 102 paragrafi (4) numri: “1,2” zëvendësohet me numrin: “0,8”.

Neni 11

Në nenin 105 paragrafi (1) në pikën v) pas fjalës: ”depozitë” lidhëza: “dhe” zëvendësohet me presje, ndërsa fjalët: “letra tjera me vlerë” zëvendësohen me fjalët: “shkresa dhe fletobligacione komerciale”.

Në pikën e) fjalët në rreshtin e parë “letra me vlerë” zëvendësohen me fjalën “fletobligacione”, kurse pas fjalës “Maqedonia” në rreshtin e dytë shtohen fjalët: “përveç atyre të emetuara ose të garantuara nga banka”;

Në pikën i) fjalët: “fletobligacione dhe të tjera” zëvendësohen me fjalën “debitore”, kurse fjalët: “me të hyra fikse” fshihen;

Në pikën j) fjalët: “edhe letrat me vlerë” zëvendësohen me fjalët: “të emetuara nga kompanitë ose bankat e huaja”.

Neni 12

Neni 138 ndryshon si vijon:

“(1) Të siguruarit të cilët për herë të parë inkuadrohen në sigurimin e obligueshëm pensional dhe invalidor pas 1 janarit 2003, kurse para datës të dhënies së lejeve për themelimin e shoqërive, janë të obliguar të anëtarësohen në fondin pensional deri në datën e përcaktuar në nenin 58 paragrafi (4) të këtij ligji.

(2) Të siguruarit të cilët për herë të parë inkuadrohen në sigurimin e obligueshëm pensional dhe invalidor pas datës të dhënies së lejeve për themelimin e shoqërive, kurse para datës të përcaktuar në nenin 58 paragrafi (4) të këtij ligji, janë të detyruar të anëtarësohen në fondin pensional më së voni deri tre muaj llogaritur nga data e përcaktuar në nenin 58 paragrafi (4) i këtij ligji.”

Neni 13

Pas nenit 139 shtohen tre nene të reja 139-a, 139-b dhe 139-v si vijojnë:

“139-a

(1) Ruajtës i pronës të fondeve pensionale në periudhën prej pesë vjetësh, llogaritur nga data kur do të fillojë pagimi i kontributit në sigurimin e obligueshëm pensional me financim kapital në pajtim me nenin 58 paragrafi (4) i këtij ligji, do të jetë Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

(2) Pas skadimit të katër vjetëve nga kryerja e rolit ruajtës të pronës së fondeve pensionale nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, Agjencia do të bëjë vlerësim se a janë të gatshme bankat në Republikën e Maqedonisë për kryerjen e rolit ruajtës të pronës dhe do ta informojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë. Në bazë të vlerësimit do të konstatohet se, pas skadimit të pesë vjetëve, a do të jetë Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë edhe më tej ruajtëse e pronës ose këtë rol do ta marrin bankat në Republikën e Maqedonisë.

139-b

(1) Ndaj Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, si ruajtëse e pronës të mjeteve të fondeve pensionale, në mënyrë adekuate do të zbatohen dispozitat për kushtet dhe mënyrën e kryerjes së rolit ruajtës i pronës së këtij ligji, përveç dispozitave nga neni 116 dhe 122 të këtij ligji.

(2) Dispozitat nga neni 18 të këtij ligji kanë të bëjnë edhe me të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

(3) Në periudhën e përcaktuar në nenin 139-a paragrafi (1) i këtij ligji, nuk do të zbatohet kufizimi nga neni 108 paragrafi (1) pika d) nënpika 2) e këtij ligji.

139-v

(1) Ndaj Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në kryerjen e rolit ruajtës të pronës të fondeve pensionale, nuk do të zbatohen dispozitat lidhur me mënyrën e kryerjes së kontrollit nga neni 47 dhe neni 53 të këtij ligji.

(2) Kontrolli i kryerjes së rolit ruajtës të pronës së mjeteve të fondeve pensionale nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 3/2002, 51/2003 dhe 85/2003).”

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi ditën vijuese nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.